



Instituti Alb-Shkenca
Tiranë – Prishtinë – Shkup



Instituti ALB-SHKENCA dhe Akademia e Shkencave të Shqipërisë

në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës

ORGANIZOJNË

Takimin XX Vjetor Ndërkombëtar me temë:

“Kontributi i Diasporës shkencore për integrimin në hapësirën europiane të kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë në trojet shqiptare”.

Tiranë, 26 – 27 Shtator 2025



Instituti Alb-Shkenca, strukturë shkencore joqeveritare e jofitimprurëse që bashkon studiues të gjitha disiplinave nga diaspora e nga mbarë trojet shqiptare në Ballkan, institucioni i parë shkencor mbarëshqiptar njofton fillimin e përgatitjeve për Takimin e XX Vjetor Ndërkombëtar të tij.

Ky Takim jubilar i IASH do të organizohet së bashku me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës në 26 – 27 Shtator 2025 në mjediset e Akademisë së Shkencave, Tiranë.

Ftohen anëtarët e Institutit Alb-Shkenca dhe të gjithë studiuesit e tjerë nga rajoni dhe diaspora që janë pjesë e strukturave akademike shqiptare, kërkuesit e pavarur, si dhe shkencëtarët e huaj të lidhur ose jo me çështjet shqiptare, të marrin pjesë në këtë tubim të madh shkencor.

Në pajtim me frymën dhe traditën e Institutit Alb-Shkenca, të interesuarit janë të ftuar të kumtojnë në Takim arritjet e tyre më të reja në fushat specifike të hulumtimit e të ekspertizës.

PANELET TEMATIKE

PANELI 1 Tema: “Kërkimi shkencor i paraprin zhvillimit të arsimit të lartë – Roli dhe kontributi i diasporës shkencore shqiptare për integrimin në hapësirën kërkimore dhe arsimore evropiane”

PANELI 2 Tema: “Mbështetja e Institucioneve kërkimore për prioritetet e zhvillimit”

PANELI 3 Tema: “Kërkimet shkencore dhe sfidat e albanologjisë në shekullin XXI: Tradita dhe risi”

FUSHAT-DREJTIMET SHKENCORE sipas të cilave do të organizohen konferencat janë:

- Filologjia, Historia dhe Kultura
- Drejtësia
- Ekonomia
- Bujqësia dhe Agrobiznesi
- Shkencat e Natyrës dhe Mjedisit
- Mjekësia
- Inxhinieria dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
- Shkencat Shoqërore dhe Politike

DËRGIMI I PUNIMEVE

Përmbledhjet e punimeve për botim duhen të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Përmbledhja duhet të jetë dygjuhëshe, shqip dhe anglisht.
- Përmbledhja duhet të përmbajë 500 – 800 fjalë dhe 3 – 5 fjalë çelës.
- Përmbledhja e punimit duhet të përmbajë: titullin, autorin kryesor, bashkautorët dhe adresat e tyre; dhe duhet të paraqesë qëllimin e punimit, metodën e përdorur, rezultatet e përftuara, si dhe përfundimet kryesore.
- Përmbledhja e punimit duhet të formatohet sipas rregullave të botimeve të IASH-së, që mund të shihen në faqen e Takimit në <http://iash-takimet.org>

Regjistrimi i përmbledhjeve/abstrakteve bëhet on-line vetëm nëpërmjet sistemit ALPA, në adresat: <http://alpa.mali-it.eu/tv2025/home/?l=al>.

Adresa zyrtare e Takimit XVII të IASH është: takimi2025@alb-shkenca.org

DATA ME RËNDËSI

Dërgimi i përmbledhjeve **deri më 15 qershor 2025**

Miratimi i përmbledhjeve deri më 15 korrik 2025

Pagesa e tarifës së pjesëmarrjes deri më 30 korrik 2025

INFORMACIONE SHITESË PËR TË INTERESUARIT

Kumtesat dhe i gjithë komunikimi gjatë Takimit të XX-të Ndërkombëtar të IASH do të zhvillohen në gjuhën shqipe dhe angleze

- Kumtesat duhet të jenë origjinale (të pakumtuara në ndonjë veprimtari tjetër), të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi ose botimi (në ndonjë redaksi tjetër);
- Një autor, mund të paraqitet në Takim më së shumti me 2 (dy) punime gjithsej;
- Përmbledhjes së punimit duhet t'i prijë shënimi se në cilën konferencë dëshironi të paraqiteni
- Autorët janë përgjegjës për redaktimin gjuhësor të tekstit të përmbledhjes së punimeve të tyre
- Pjesëmarrësit marrin Certifikatën e pjesëmarrjes
- Përmbledhjet botohen në Librin e Përmbledhjeve – Proceedings' Book
- Punimet e plota pas recensimit shkencor nga dy recensentë, sipas rregullit “double blind”, botohen në revistën shkencore të Institutit Alb-Shkenca AKTET, e cila ka numrin ISSN2073-2244 dhe del që nga 2007.

KËSHILLI SHKENCOR (Scientific Committee):

Kryetarë:

Gentian Zyberi, Norvegji
Ardian Maçi, Shqipëri
Anila Hoda, ASHSH

Nënkryetarë:

Eshref Januzaj, Gjermani
Fatos Ylli, Shqipëri
Ali Caka, Kosovë
Zeqirja Neziri, Maqedonia e Veriut
Neki Frashëri, ASHSH
Gëzim Hoxha, ASHSH

Koordinatorë e Takimit XX

Shpresa Tafaj (Caslli), Shqipëri

Anëtarë nderi të Institutit Alb Shkenca

Niko Qafoku, SHBA, kryetar nderi IASH
Sami Repishti, SHBA (†)
Emil Lafe, Shqipëri
Jahja Kokaj, Kosovë
Nebi Caka, Kosovë
Shpresa Hoxha, Kosovë

Anëtarë:

Albert Doja, Shqipëri
Ardian Harri, ShBA
Arben Merkoçi, Spanjë
Arjana Ylli, Shqipëri
Bajram Berisha, Kosovë
Ernest Nasto, ShBA

Evan Roço, Shqipëri
Fahrije Tahiri, Kosovë
Florian Kongolli, Kanada.
Jahja Kokaj, Kosovë
Julian Shehu, Shqipëri
Kristaq Jorgo, Shqipëri
Lulzim Dragidella, Gjermani
Lumnije Kçiku, Austri
Lluka Qafoku, Shqipëri
Nebi Caka, Kosovë
Neim Rustemi, Norvegji
Mustafa Ibrahim, Maqedonia e Veriut
Musa Rizaj, Kosovë
Neki Frashëri, Shqipëri
Nysret Musliu, Austri
Petraq Papajorgji, Shqipëri
Ramadan Dervishi, Kosovë
Robert Magari, ShBA
Roza Allabashi, Austri
Shahin Berisha, SHBA
Vehbi Neziri, Kosovë
Vlora Podvorica, Kosovë
Fatmir Hoxha, ASHSH
Floran Vila, ASHSH
Genc Sulçebe, ASHSH
Ilia Mikerezi, ASHSH
Jorgaq Kaçani, ASHSH
Neritan Ceka, ASHSH
Paskal Milo, ASHSH
Vasil S. Tole, ASHSH
Anila Paparisto, Universiteti i Tiranës
Eglantina Kalluçi, Universiteti i Tiranës

KËSHILLI ORGANIZUES

Gentian Zyberi, Norvegji
Ardian Maçi, Shqipëri
Alketa Hoxha, Shqipëri
Anila Hoda, ASHSH
Besnik Dobi, Shqipëri
Edlira Birko, Shqipëri

Edlira Sadiku, Shqipëri
Eshref Januzaj, Gjermani
Fatos Ylli, Shqipëri
Musa Rizaj, Kosovë
Bashkim Ziberi, Maqedonia e Veriut
Mentor Hamiti, Maqedonia e Veriut

Ju mirëpresim!
Instituti Alb-Shkenca